

VENDIM
Nr. 531, datë 7.9.2023

**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE SHTETËRORE “OPERATORI I
BLERJEVE TË PËRQENDRUARA” SHA, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË**

(Ndryshuar me VKM nr. 813, datë 28.12.2013; nr. 768, datë 13.12.2024; nr. 67, datë 29.1.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e shoqërisë aksionare, me kapital 100% shtetëror, me emërtimin Operatori i Blerjeve të Përqendruara (në vijim “OBP”), për ofrimin e shërbimeve të prokurimeve për autoritetet/entet kontraktore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Shoqëria aksionare, sipas përcaktimeve në pikën 1 të këtij vendimi, themelohet, organizohet dhe funksionon, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

3. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare, është ministria përgjegjëse për ekonominë.

4. Kapitali fillestar i regjistruar për krijimin e shoqërisë aksionare të jetë 20 000 000 (njëzet milionë) lekë dhe përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Ministria përgjegjëse për ekonominë transferon këtë shumë pranë kësaj shoqërie menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ministria përgjegjëse për ekonominë ndjek procedurat e nevojshme ligjore, për:

- a) themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë aksionare;
- b) regjistrimin e shoqërisë aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. OBP sh.a. është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.

6. Organet drejtuese të shoqërisë aksionare OBP sh.a., sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, janë: Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori. Detyrat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikëqyrës rregullohen dhe funksionojnë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe statutit të OBP sh.a.

7. Administratori i OBP sh.a. emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe statutit të shoqërisë. Kriteret për emërimin e drejtuesit të shoqërisë janë, si më poshtë vijon:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë ose të barasvlershme me ta, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

d) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në profesion, prej të cilave 3 (tre) vjet në pozicione drejtuese apo menaxheriale në sektorin publik apo privat;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.

8. Administratori i OBP sh.a., lirohet nga detyra, kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;

c) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;

ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit.

9. Administratori i OBP sh.a. shkarkohet nga detyra, kur:

a) kryen shkelje të rënda të etikës;

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

ç) me vendim gjyqësor të formës së prerë i është kufizuar apo hequr zotësia për të vepruar.

10. Me qëllim realizimin me efektivitet dhe efektshmëri të procedurave të prokurimit, administratori i OBP sh.a., mund të marrë këshilltarë të jashtëm apo ndihmës të jashtëm, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.

11. Operatori i Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, zhvillon procedurat e mëposhtme në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve dhe më hollësisht sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi:

a) Blerje automjesh, autoveturash, ambulancash, mjesh rrugore që përdoren për transport njerëzish, mjesh rrugore që përdoren për transport mallrash, autobusësh, makinash teknologjike, makinash bujqësore dhe motomjesh;

b) blerje karburanti, me përjashtim të vajgurit Jet A1 dhe karburantit që prokurohet për përdorim nga fermerët;

c) blerje materialesh kancelarie;

ç) blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim;

d) blerje materialesh të ndryshme për pastrim;

dh) blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;

e) blerje këpucësh;

ë) blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;

f) blerje tonerash;

g) shërbime në fushën e sigurimeve, si:

i. sigurim i automjeteve;

ii. sigurim i mjeteve lundruese;

iii. sigurim i mjeteve ajrore;

iv. sigurim jete dhe shëndeti;

v. sigurim i godinave publike;

gj) shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi;

h) shërbim pastrimi;

i) shërbim lavanderie;

j) shërbim lyerjeje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave publike;

k) riparim dhe mirëmbajtje automjesh;

l) botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;

ll) blerje materialesh të buta dhe veshmbathjesh;

- m) riparim e mirëmbajtje sistemesh të ngrohje-ftohjeve;
 - n) blerje pajisjesh laboratorike, si dhe mjete didaktike, të lidhura me proceset e tyre të punës, me përjashtim të atyre mjekësore;
 - nj) shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi;
 - o) blerje artikujsh ushqimorë;
 - p) blerje pajisjesh kondicionimi;
 - q) shërbim gjelbërimi;
 - r) rikonstrukcion objektsh;
 - rr) *Përzgjedhja e subjekteve private me eksperiencë ndërkombëtare si ofrues shërbimi në fushën e prokurimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik";*
 - s) *Qira operationale automjeteve;*
 - sh) *Blerje kamerash/sistemesh vëzhgimi dhe alarmi;*
 - t) *Blerje dhe/ose mirëmbajtje asensorësh;*
 - th) *Blerje pajisjesh/pjesësh për burimin, ushqimin dhe energjinë (BUE);*
 - v) *Ndërtime;*
 - x) *Supervizime dhe kolaudime të punimeve që i përkasin procedurave të prokurimit, objekt të veprimtarisë së Operatorit të Blerjeve të Përqendruara;*
 - xh) *Blerje materialeve elektrike, hidraulike dhe ndërtimi;*
 - y) *Mirëmbajtje e sistemeve/implanteve elektrike, hidraulike.*
- 11/1. *Bëjnë përjashtim nga parashikimet e pikës 11, të këtij vendimi, institucionet që realizojnë vetë procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, si më poshtë vijon:*
- a) *Shtypshkronjat e letrave me vlerë;*
 - b) *Shërbimi Informativ i Shtetit.*
12. OBP sh.a., me kërkesë të një apo të disa autoriteteve/enteve kontraktore, zhvillon procedura prokurimi edhe për punë/mallra/shërbime, të cilat nuk janë listuar në pikën 11, të këtij vendimi, në rastet kur autoriteti/enti kontraktor kërkuar nuk ka kapacitete apo njohuri të mjaftueshme për realizimin e një procedure prokurimi.
- 12/1. *OBP sh.a., zhvillon, gjithashtu, procedura prokurimi për punë/mallra/shërbime për llogari të autoritetit/entit kontraktor, i cili në strukturën e tij organizative ka më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës dhe nuk ka një organ efitor.*
- 12/2. *Institucionet që kërkojnë të prokurojnë shërbime/mallra/punë të cilat përfshihen në objektet e prokurimit të listuara në pikën 11, të këtij vendimi, me vlerë mbi 1 000 000 (një milion) lekë pa TVSH, dërgojnë kërkesat për prokurim pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, pavarësisht numrit të punonjësve që ka institucioni.*
13. Autoritetet/entet kontraktore duhet t'i dërgojnë OBP sh.a., si organ qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe të dhëna për fondin përkatës për mallrat e shërbimet përkatëse, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga detajimi/rialokimi i buxhetit.
- 13/1. *Autoritetet/entet kontraktore paraqesin kërkesën për prokurim në formë shkresore dhe elektronike, në të cilën bashkëlidhin në formën e dubur të dhënat e domosdoshme teknike dhe sasiore që janë të nevojshme për procedurën, objekt prokurimi, duke përfshirë:*
- a) *përshkrimin/emërtesën e objektit të prokurimit, i cili të përputhet me zërin përkatës në regjistrin e parashikimit;*
 - b) *vlerën e përlllogaritur të kontratës (pa TVSH) dhe mënyrën e përlllogaritjes, fondi limit, në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimet publike dhe rregullave të prokurimeve publike, shoqëruar me dokumentacionin provues të këtij procesi;*
 - c) *sasinë e mallrave/shërbimeve, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave/shërbimeve;*
 - ç) *specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, projektin apo opionencën teknike, nëse është rasti, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e*

elementeve më të rëndësishme referuar parashikimeve konkrete të ligjit për prokurimet publike dhe rregullave të prokurimeve publike, të shoqëruar me procesverbal argumentues;

d) preventivin/at e punimeve, nëse është rasti, projektet teknike, grafikun e zbatimit të punimeve, i cili të përfshijë fazat, afatet e realizimit të punëve, vendin e realizimit të kontratës/furnizimit/dorëzimit të mallit/shërbimit.

13/2. Për kërkesat për prokurim me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, dokumentacioni i nevojshëm duhet të dërgohet në gjuhën shqipe dhe në anglisht nga autoritetet/entet kontraktore.

13/3. Pasi OBP sh.a. shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti/enti kontraktor, lidhur me përputhshmërinë me parashikimet ligjore e nënligjore dhe standardet në fuqi, vlerëson, nëse është e nevojshme, që kërkesat e paraqitura të plotësohen për shkak se dokumentacioni, përmbajtja e kërkesës, specifikimet teknike, termat e referencës, afatet e lëvrimit, si edhe llogaritja e fondit limit janë paraqitur jo në përputhje me detyrimet ligjore për prokurimet publike. Nëse gjykohet se specifikimet teknike apo dokumentacioni tekniko-ekonomik, bashkëlidhur në kërkesën e paraqitur, nuk janë përgatitur në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, OBP sh.a. i kërkon autoritetit/entit kontraktor t'i korrigjojë ato brenda 10 (dhjetë) ditëve.

13/4. OBP sh.a. standardizon/unifikon specifikimet teknike/çmimet për mallra dhe/ose për shërbime që prokurohen në mënyrë të përqendruar, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas apo të huaj, dhe harton katalogët e standardeve. Katalogët e standardeve janë orientues dhe rekomandues për autoritetet/entet kontraktore. Katalogët e standardeve përgatiten nga drejtoria përkatëse e OBP sh.a., miratohen nga administratori dhe publikohen në faqen zyrtare të OBP sh.a. dhe të APP-së.

14. Mënyra e organizimit dhe komunikimit institucional mes OBP sh.a. dhe autoriteteve kontraktore për çështjet në tërësi dhe veçanërisht për katalogët e standardeve rregullohet në rregulloren e miratuar nga OBP sh.a., sipas parashikimit të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

15. Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. ka përgjegjësi të organizojë punën për kryerjen e procedurave të prokurimit, për të nënshkruar marrëveshjen kuadër, për të zhvilluar procedurën e konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë në një marrëveshje kuadër, si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.

16. Shoqëria aksionare financohet nga të ardhurat e veta, të ardhura nga shërbimet ndaj të tretëve, të konsulencës, nga ofrimi i shërbimeve dhe burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat e shoqërisë aksionare përdoren për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

17. Shoqëria aksionare mund të ofrojë shërbime të tjera shitesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit, fushën e veprimtarisë dhe statutin e saj.

18. OBP sh.a., për nevojat e saj mund të nënshkruajë:

a) marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përkatëse brenda fushës së kompetencave të tyre për ofrimin e asistencës teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) marrëveshje bashkëpunimi me entitete publike apo organizma ndërkombëtarë, me qëllim marrjen e ndihmës/ekspertizës së nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi apo rritjen e kapaciteteve institucionale;

c) marrëveshje bashkëpunimi me ekspertë të fushave të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi.

19. Ministria përgjegjëse për ekonominë i siguron shoqërisë aksionare mjediset e punës, të nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.

20. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP) do të vijojë të kryejë procedurat e veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë deri në fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së Organit të Blerjeve të Përqendruara sh.a. (OBP).

21. Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. njofton me shkrim institucionet e përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, për datën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, datë e cila përcaktohet me urdhër të ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Procedurat e prokurimit, që nuk janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, deri në momentin e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së OBP sh.a., nuk i adresohen ASHPP-së.

22. Me mbylljen e veprimtarisë së ASHPP-së brenda 30 (tridhjetë) ditëve, inventari ekonomik,

dokumentar dhe arkivi elektronik në Sistemin e Prokurimit Elektronik transferohet pranë OBP sh.a.-së. Për punonjësit aktualë të Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara, në rastin e mbylljes së institucionit, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

23. Me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së OBP sh.a., vendimi nr. 393, datë 9.6.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara dhe ngarkimin e kësaj agjencie për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë", shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
(Shtuar me vendimin nr. 768, datë 13.12.2024)

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. kryen procedurat e prokurimit për kontratat e mallrave/shërbimeve/punëve, si më poshtë:

a) Blerje automjesh, autoveturash, ambulancash, mjetesh rrugore që përdoren për transport njerëzish, mjetesh rrugore që përdoren për transport mallrash, autobusësh, makinash teknologjike, makinash bujqësore, motomjesh

Në këtë kategori përfshihen mjetet motorike të reja dhe të përdorura. Automjete, autovetura, ambulanca, mjete rrugore që përdoren për transport njerëzish, mjete rrugore që përdoren për transport mallrash, autobusë, makina teknologjike, makina bujqësore, motomjete, si edhe automjete të përdorura.

b) Blerje karburanti

Në këtë kategori përfshihen këto kategori: naftë D1, benzinë, naftë F 76, solar. Në këtë kategori nuk përfshihen vajguri Jet A1 dhe karburanti për nevojat e fermerëve.

c) Blerje materialesh kancelarie

Në këtë kategori përfshihen të gjitha materialet e një natyre të përgjithshme që përdoren nga të gjitha institucionet për operacionet e tyre të përditshme.

Gjithashtu, këtu përfshihen edhe artikuj të imët të zyrës e të tjera pajisje të imta të ngjashme.

ç) Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyre

Materialet që do të prokurohen në këtë grup përfshijnë këto kategori: tavolina, karrige, skrivani, poltrona, etazherë (rafte), kasaforta, dollapë, komodina, si dhe materiale të tjera që janë në funksion të institucioneve që janë në fushën e zbatimit të këtij vendimi.

d) Blerje materialesh të ndryshme për pastrim

Në këtë kategori përfshihen të gjitha materialet e nevojshme për pastrim, si dhe detergjentë, dezinfektantë e të tjera materiale të kësaj natyre.

dh) Blerje uniformash, veshmbathjeje dhe elemente të tjera përbërëse të tyre

Në këtë kategori përfshihen: uniformat e strukturave të mbrojtjes, rendit, gardës, doganave etj., si dhe çdo lloj uniforme tjetër e detyrueshme për institucionet që janë në fushën e zbatimit të këtij

vendimi. Në këtë kategori përfshihen edhe elementet e tjera përbërëse të tyre sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

e) Blerje këpucësh

Në këtë kategori përfshihen këpucë uniforme, stërvitjeje, ceremoniali, sportive (atlete) dhe civile për punonjësit etj., si dhe çdo lloj uniforme tjetër e detyrueshme për institucionet që janë në fushën e zbatimit të këtij vendimi. Në këtë kategori përfshihen edhe elementet e tjera përbërëse të tyre sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

ë) Blerje pjesësh ndërrimi për automjete

Në këtë kategori do të përfshihen: blerje gomash, baterish, vajrash lubrifikant, alkooli frenash dhe pastrues motori për mjetet motorike, të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 11, të këtij vendimi, vendosja e të cilave kryhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor.

f) Blerje tonerësh

Në këtë kategori do të përfshihen: tonerë, e bojëra printeri, fotokopje. Në këtë kategori përfshihen edhe elementet e tjera përbërëse të tyre sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

g) Shërbime në fushën e sigurimeve, si:

i. Sigurim i automjeteve; ii. sigurim i mjeteve lundruese; iii. sigurim i mjeteve ajrore; iv. sigurim jete dhe shëndeti; v. sigurim i godinave publike.

gj) Shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi

Në këtë kategori do të përfshihet shërbimi katering (gatim dhe/ose shpërndarje).

h) Shërbim pastrimi

Në këtë kategori përfshihet shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme.

i) Shërbim lavanderie

Në këtë shërbim përfshihen shërbim larjeje, hekurosjeje, paketimi të materialeve të imta/buta spitalore, shtrim të materialeve të imëta etj.

j) Shërbim lyerjeje ndërtesash dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave publike

Në këtë kategori përfshihet shërbimi i lyerjes së ndërtesave në ambientet e brendshme dhe të jashtme, dhe çdo element i mirëmbajtjes së ndërtesave publike, si: punime civile, elektrike, hidraulike, furnizim e vendosje mallrash/pajisjesh në funksion të objekteve të prokurimit etj.

k) Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh

Në këtë kategori do të përfshihen të gjitha shërbimet e parashikuara në kuadër të riparim-mirëmbajtjes për mjetet motorike të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 11, të këtij vendimi, si për shembull: kontrollet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj., nga operatori ekonomik.

l) Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi

Në këtë kategori do të përfshihen të gjitha nevojat që ka autoriteti kontraktor/enti kontraktor për shërbimin e printimit, prodhimit të botimeve të ndryshme apo materialeve të shtypshkrimit. Me përjashtim të botimeve për tekstet shkollore të arsimit bazë për institucionet arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare.

ll) Blerje materialesh të buta dhe veshmbathjeje

Në këtë kategori do të përfshihen të gjitha materialet e nevojshme për autoritetet/entet kontraktore, të cilat në ushtrim të veprimtarisë së tyre ofrojnë shërbimin e fjetjes, si: veshmbathje, çarçafë, peshqirë, dyshekë etj.

m) Riparim, mirëmbajtje sistem ngrohje-ftohje

Në këtë kategori do të përfshihen mirëmbajtja apo riparimi i sistemit të ngrohje-ftohjes që përdor autoriteti kontraktor (kondicioner, *chillera*, kaldaja, rrjeti i sistemit HVAC që përfshin linja të furnizimit me gaz dhe me ujë, kanalet e ventilimit, dhoma teknike etj.), duke konsistuar në kontrolle, riparime, zëvendësim të pjesëve të nevojshme etj.

n) Blerje pajisjesh laboratorike dhe të mjeteve didaktike, me përjashtim të atyre mjekësore

Në këtë kategori do të përfshihen të gjitha shpenzimet që parashikohen të prokurohen nga autoriteti/enti kontraktor për blerjen e pajisjeve laboratorike të ndryshme, të cilat shkojnë në funksion të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të atyre me natyrë mjekësore.

nj) Shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi

Në këtë kategori do të përfshihen të gjitha shpenzimet që parashikohen të prokurohen nga autoriteti/enti kontraktor për dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin e ambienteve të jashtme apo të brendshme.

o) Blerje artikujsh ushqimorë

Në këtë kategori do të përfshihen të gjitha blerjet e artikujve ushqimorë për autoritetin/entin kontraktor me natyrë bimore, shtazore, industriale etj. Në këtë kategori nuk përfshihet rasti kur autoriteti kontraktor kërkon shërbimin e kateringut (gatim dhe shpërndarje).

p) Blerje pajisjesh kondicionimi dhe sistemi ngrohje-ftohje

Në këtë kategori do të përfshihen pajisjet që konsistojnë në sisteme të ngrohjes dhe ftohjes si kondicioner, *chillera* etj.

q) Shërbim gjelbërimi

Në këtë kategori do të përfshihen shërbimet e parashikuara nga autoriteti/enti kontraktor për gjelbërimin e ambienteve të jashtme të autoritetit/entit kontraktor, duke konsistuar në mbjellje, mirëmbajtje të hapësirave të gjelbra etj.

r) Rikonstruksion objektsh

Në këtë kategori përfshihen të gjitha punimet të cilat konsistojnë në rikonstrukcione të objekteve të ndryshme shtetërore, duke konsistuar në zgjidhjet dhe koordinimin e punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen, gjithashtu, dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

rr) Përzgjedhja e subjekteve private me eksperiencë ndërkombëtare si ofrues shërbimi në fushën e prokurimeve, referuar nenit 21/2 të ligjit të prokurimit publik

Sikurse përcakton ligji nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", në rast kërkesë nga autoriteti/enti kontraktor, OPB sh.a. përzgjedh subjekte private me eksperiencë ndërkombëtare, si ofrues shërbimi, sipas procedurave të parashikuara në ligjin për prokurimin publik dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Kërkesat e autoriteteve duhet të konsistojnë në përzgjedhjen e subjekteve që mund të realizojnë procedura prokurimi që nuk kryhen nga OBP-ja.

s) Qira operationale automjeteve

Në këtë kategori përfshihet marrja me qira e automjeteve përmes qirasë operationale. Konkretisht, autovetura, ambulanca, mjete rrugore që përdoren për transport njerëzish, mjete rrugore që përdoren për transport mallrash, autobusë, makina teknologjike, makina bujqësore, motomjete.

sh) Blerje kamerash/sistemesh vëzhgimi dhe alarmi

Në këtë kategori përfshihen furnizimi i vendosjes së kamerave, pajisjeve të alarmit, trarëve, akses-kontrolleve, monitorëve etj.

t) Blerje dhe/ose mirëmbajtje ashensorësh

Në këtë kategori përfshihen blerje dhe/ose mirëmbajtje ashensorësh në funksion të institucioneve objekt të këtij vendimi.

th) Blerje pajisjesh/pjesësh për burimin, ushqimin dhe energjinë (BUE)

Në këtë kategori përfshihen gjeneratorë, UPS-a, transformatorë, çela, panele diellore etj.

v) Ndërtime

Në këtë kategori përfshihen të gjitha punimet e ndërtimeve civile në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje etj.

x) Supervizime dhe kolaudime të punimeve që i përkasin procedurave të prokurimit që janë në fushën e veprimtarisë së OBP-së, sipas parashikimeve në këtë VKM

Në këtë kategori përfshihen supervizimet dhe kolaudimet e punimeve të ndërtimit për rikonstrukcion dhe ndërtim.

xh) Blerje materialesh elektrike, hidraulike dhe ndërtimi

Në këtë kategori përfshihet blerja e artikujve elektrikë, hidraulikë, të ndërtimit etj.

y) Mirëmbajtje e sistemeve/impianeteve elektrike, hidraulike

Në këtë kategori përfshihet mirëmbajtja e sistemeve/impianeteve elektrike, hidraulike ekzistuese në objektet e institucioneve, si: kontrolle, riparime, zëvendësime etj.